

DEBATI 'VIZIONET UTOPIKE - DËSHTIMET E QEVERISË NË KRYEQYTETIN E KOSOVËS'

# PLANI I MIRË DUHET TË JETË EDHE I ZBATUESHËM

**Iniciativa Kosovare për Stabilitet (ESI) konsideron se një qytet, që sot ka rreth 220.000 banorë, dhe mund të rritet deri në 250.000 banorë në vitin 2020, ka nevoja të tjera të investimeve dhe infrastrukturave**

Prishtinë, 8 qershor

Iniciativa e Kosovare për Stabilitet (ESI) në një debat të organizuar në Prishtinë "Vizionet utopike - dëshimet e Qeverisë në kryeqytetin e Kosovës" ka paraqitur vizionet se si duhet të zhvillohet dhe të ndërtohet Prishtina si kryeqytet. Ky hulumtim i ESI-t është mundësuar me përkrahjen e "Balkan Trus for Democracy" dhe "Austrian Ester Bank Privatstiftung". Në këtë diskutim ishin të pranishëm ministri i Planifikimit Hapësinor, Ardian Gjini dhe kryetari i Komunës së Prishtinës, Ismet Beqiri.

Zyrtarët e ESI-t thanë se është vendimtare që plani i mirë të jetë edhe i zbatueshëm. Kjo nënkupton një bashkëpunim më të ngushtë në mes të drejtorive të ndryshme komunale, institucioneve komunale dhe atyre qendrore, si dhe organizatave që ende varen nga AKM-ja, siç është fjala për ndërmarrjet e shërbimeve publike.

Një bashkëpunim i tillë ka munguar deri më sot, njoftojnë zyrtarët e Iniciativës. Zbatimi i efektit i planit po ashtu nënkupton buxhetet reale që përqendrohen në prioritetet të mirëfillta.

Analiza socio-ekonomike e situatës së tanishme, sipas ESI-t, është e bazuar në studime të mirëfillta. ESI



konsideron se një qytet që sot ka rreth 220.000 banorë, dhe mund të rritet deri në 250.000 banorë në vitin 2020, ka nevoja të tjera investime dhe infrastrukturave nga një qytet me 650.000 banorë. Një qytet që hyjnë mesatarisht 12.000 vetura në ditë, nuk i duhen udhëkryqet me kapacitet prej 70.000 vetura.

Zyrtarët e ESI-t theksuan se "një plan i mirë duhet t'i adresojë problemet e tanishme të qytetarëve të sotëm, e jo ato të një qyteti të imagjinuar utopik të një të ardhme të largët". Po ashtu zyrtarët thanë se shumica e familjeve që do të jetonin në Prishtinë në vitin 2020, janë duke jetuar këtu edhe sot dhe një plan i

mirë do të duhet t'i trajtonte nevojat e tyre. Këto nevoja natyrisht dallojnë njëra nga tjetra, konsideruan zyrtarët e ESI-t, varësisht nga ajo se ku jetojnë ata banorë, në lagjen "Arbëri" apo "Kodra e Trimave", "Kalabria" apo "Ulpiana".

E. IMERI

## PËRURORHET RRUGA BUSI - MRAMOR

**Asfaltimi i kësaj rruge është financuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe ka kushtuar 144.974,75 mijë euro**

Bëhet përzirimi i asfaltimit të rrugës Mramor - Busi me gjatësi 4 km. Në përzirimin e rrugës, përveç kryetarit të KK të Prishtinës dhe drejtorëve, ishin të pranishëm edhe kryedemokratit i Prishtinës dhe shefi i Zyrës Turke. Asfaltimi i kësaj rruge është financuar nga buxheti i KK të Prishtinës dhe ka kushtuar 144.974,75 mijë euro. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Ismet Beqiri, i përgëzoi fshatarët për rrugën e asfaltuar dhe u premtoi banorëve realizimin edhe të projekteve të tjera. Ndërkaq, nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Shefki Gasti, tha se do të bëhen përpjekje që të vazhdohet të realizohen premtimet e dhëna edhe për ndërtimin e një palestere sportive. Ai më tej shtoi se asfaltimi i kësaj rruge është edhe një arsye më shumë që banorët të kthehen nëpër shtëpitë e tyre dhe ata të çliet jetojnë në këtë fshat është një arsye më pak për të lëshuar fshatin. Punimet për këtë rrugë është dashur të përfundojnë vitin e kaluar.

E. IMERI